Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr/Br. 129/17
Date/Datum 14.06.17

PSH.nr. 129/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina-Kryetar, z. Goran Milenković - Referues, z. Nuhi Paçarizi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N. P. T. SH "Bubeari Komerc"-Kaçanik, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me gazra medicinale" me nr. prok. QKUK 701/17/002/111, iniciuar nga AK-/Qendra Klinike Universitare e Kosovës/ më datën 08.06.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet** si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N. P. T. SH "Bubeari Komerc"-Kaçanik, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me gazra medicinale" me nr. prok. QKUK 701/17/002/111, iniciuar nga AK-/Qendra Klinike Universitare e Kosovës/

II. **Anulohet,** njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së / Qendra Klinike Universitare e Kosovës /, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: "Furnizim me gazra medicinale" me nr. prok. QKUK 701/17/002/111, dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N. P. T. SH "Bubeari Komerc"-Kaçanik, aprovohet si e bazuar, i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:31.01.2017.

Hapja e ofertave është bërë me dt:10.03.2017 ku kanë marr pjesë këtë operator ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me ketë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:11.04.2017, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Masser GTM"-Mitrovicë.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik N. P. T. SH "Bubeari Komerc"-Kaçanik, me dt: 18.04.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 19.04.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet si pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik, N. P. T. SH "Bubeari Komerc"-Kaçanik,

Operatori ekonomik ankues N. P. T. SH "Bubeari Komerc"-Kaçanik, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 24 Prill 2017 me nr. 129/17 kundër njoftimit për dhënie te kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me gazra medicinale" me nr. prok. QKUK 701/17/002/111, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues "Qendra Klinike Universitare e Kosovës" duke pretenduar se autoriteti kontraktues, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së.

- Neni 6 i LPP-së (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti),
- Neni 7 i LPP-së(Barazia në Trajtim Jo-Diskriminimi),
- Neni 52 i LPP-së (Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës),
- Neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i Tenderëve),
- Neni 68 i LPP-së (Gjendja Ekonomike dhe Financiare),

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 03.05.2017 ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 11.05.2017, bazuar në sqarimet e cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që ta Aprovoj si të bazuar ankesën OE NPTSH "Bubeari", me seli në Kaçanik, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të anuloj vendimin "Njoftimin për dhënie të kontratës, i datës 11.04.2017, me titull: "Furnizim me gazra medicinale" me nr. prok. QKUK 701/17/002/111, iniciuar nga AK-Qendra Klinike Universitare e Kosovës, dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Ri-Vlerësim

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datë: 12.05.2017, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues

Operatori ekonomik ankues me datë: 15.05.2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 08.06.2017, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti e OSHP-së, vëzhgues nga OJQ "D Plus" znj. Sara Zhubi, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues:"Bubeari Komerc" z.Guri ka deklaruar: Sa i përket vlerësimit të AK-së e ndjej veten si kompani të dëmtuar. Arsyeja është se i kemi plotësuar gjitha kriteret dhe deri sot e kemi furnizuar vazhdimisht pa asnjë vërejtje, është tenderi i dytë, dhe nuk ka mundësi të lindin tani dyshime se nuk jemi të përgjegjshëm. Jemi shpall të papërgjegjshëm me arsyen e gabimeve aritmetikore, dhe sipas nenit 59 të LPP-së për llogaritje merret çmimi njësi. Këtu nuk është marr çmimi njësi dhe gjatë përllogaritjeve vlera e gabimit është më e vogël se 2%.

Mirëpo komisioni i AK-së kanë qenë punëtor të thjeshtë dhe asnjë punëtor nga financat që merret me këtë punë. Njoftimi është bërë në mënyrë shumë të shpejt prej AK, me 7.04.2017, ndërsa me 11.04.2017 është publikuar në internet, ne kemi marr informacione nga AK për eliminim katër ditë pas publikimit në internet. Të gjitha i kemi të deponuara me email që kemi kontaktuar me AK. Ne jemi ankuar pranë AK-së, emailin e kam marr për pezullim të vendimit për dhënie të kontratë në ora 09.32, ndërsa në ora 11.02 kemi marr përgjigje që prapë vendimi është i plotfuqishëm.

Më lind mendimi se kur u tubu komisioni dhe kur u shqyrtua lënda që të merret vendim në atë drejtim. Është kërkuar në Formular të tenderi çmimi njësi, TVSH në përqindje, dhe nuk është marr për bazë kalkulimi i çmimit njësi. Në vazhdimësi kam edhe me vete tri kontrata kopje, një e dt:21.02.2017 dhe 25.04.2017, që i kanë të njëjtat kritere dhe me tri decimale, mirëpo nuk kam qenë i diskualifikuar. Mbes me shpresë se do keni në konsideratë dhe të vendosni në favor të Bubeari Komerc dhe në favor të drejtësisë. Mirëpo kalkulimi i bërë nga AK është mbledh vlera me TVSH, që sipas ligjit për TVSH L05-037 par. 4 neni 39 "TVSH nuk guxon të rrumbullakohet por rrumbullakohet vetëm shuma në dy decimale". Por edhe nëse rrumbullakojmë gjitha çmimet njësi në dosje të tenderit nuk kapet vlera 2%, dhe për vetmin gabim që jemi shpall të papërshtatshëm.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi të AK-QKUK z. Havolli ka deklaruar: Ne si AK qëndrojmë pranë përgjigjes tonë për mospajtim me ekspertizë bazuar në UOPP nenin 18.3, pastaj tek pjesa A procedurat e tenderimit seksioni i informacioneve të dosjes së tenderit pika 20 valuta dhe kalkulimi i çmimeve, pastaj edh nga sqarimet që kemi marr nga departamenti i rregullave të KRPP-së. Vlen të ceket se kushtet e kërkesës në dosje është DDP që do thotë me gjitha detyrimet e paguara, andaj në bazë të kësaj çmimi njësi është me gjitha detyrimet e paguara. Mund të përmend se prej KRPP kemi marr sqarim ku shkruan kërkesë e LPP është që çmimet të ofrohen me gjitha taksat e aplikueshme, pra në këtë rast duhet të merren çmimet për njësi me TVSH".

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues i cili ka deklaruar: Lidhur me ankesën e OE ankues sa i përket eliminimit dhe arsyetimit se sipas nenit 18.3 të UOPP ka ndryshime në ofertë financiare, duhet të sqaroj për panelin se OE ankues në ofertë ka vetëm një pozicion i cili është ofruar me mbi numra pas pikës dhjetore, dhe në rast se e kalkulojmë këtë pozicionin (pozicioni 7 në ofertën financiare), duke vepruar sipas neni 18.3 duke marr vetëm dy numra pas pikës dhjetore pa llogaritur numrin e tretë oferta financiare nuk ka ndryshim mbi 2% për këtë ndryshim të pozicionit.

Sa i përket asaj se çmimet për njësi TVSH duhet llogariten siç deklaron përfaqësuesi i AK, sqaroj se TVSH është taksë e shtetit që nuk mund as të hiqet as të rritet e as të falet dhe duhet të aplikohet si e tillë pa marr parasysh vlerën që del pas kalkulimit dhe në këtë rast mund të merret parasysh vetëm çmimi për njësi por jo edhe pas kalkulimit të TVSH-së,.

Kjo sepse sipas nenit 59.3 të LPP-së gabimet aritmetikore duhet të kenë parasysh çmimin për njësi. Po ashtu duhet sqaruar për panelin shqyrtues se lidhur me nenin 18.3 në kohën e fundit ka një keqinterpretim me apo pa dashje prej anës së AK-ve , sepse ky paragraf ka për qëllim të eliminoj çmimet manipuluese nga praktikat e kaluara ku janë ofruar shumë shifra pas pikës dhjetore, dhe nuk ka të bëjë fare me gabime aritmetike. Gabimet aritmetike janë të paraqitura në nenin 59.3 të LPP-së. Në rastin konkret gabim aritmetikorë nënkupton gabimet në ofertën financiare të OE-ve kur ka gabim gjatë mbledhjes, shumëzimit dhe kalkulimit të çmimit njësi me sasi, dhe i njëjti nuk mund të inkuadrohet në këtë rast, pasi nenin 18.3 ka të bëjë me çmime manipuluese. Shfrytëzoj rastin të lus panelin që të marr masa të ndaloj këto praktika për të gjitha AK-të.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të OE "Messer GTM" z.Ukelli i cili deklaroj: OE i rekomanduar për kontratë nuk pajtohet me mendimin e ekspertit dhe me këtë rast eksperti po tenton të vë në lajthitje panelin e OSHP-së. Eksperti në ekspertizë me rastin e kalkulimit merr për bazë çmimin për njësi pa taksa e cila është në kundërshtim me LPP. Lidhur me këtë ne i jemi drejtuar KRPP ku kemi kërkuar sqarim në rast mospërputhjes së çmimi total dhe atij për njësi, cili çmim duhet marr për bazë , çmimi për njësi me TVSH apo pa TVSH.

KRPP është përgjigjur se "çmimet duhet të ofrohen me gjitha taksat e aplikueshme, pra duhet të merret çmimi për njësi me TVSH". Pra në këtë rast AK ka vepruar konform LPP-së pasi gabimet aritmetikore të OE ankues janë mbi 2%. Po ashtu për interpretimin e KRPP është KRPP e jo eksperti shqyrtues. Sa i përket deklarimit të OE ankues se për dy vite ka furnizuar të njëjtin AK, vlen të ceket se çmimet kanë dallim mes ofertës aktuale dhe ofertën që e ka në kontratë, për disa artikuj mbi 100% e për disa tjerë mbi 200%. Kërkojmë nga paneli të merret për bazë vendimi i AK-së dhe kundërshtojmë ekspertizën dhe të refuzohet ankesa e OE ankues si e pabazuar.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues z. Guri deklaroj: Pretendimi i OE të rekomanduar se kemi kontrata me dallime deri 200% në çmime me ofertën e tanishme, kjo diktohet nga kërkesa tregut. Qëndrojmë pranë ankesës dhe pretendimeve ankimore dhe i propozojmë panelit të aprovoj ankesën tonë si të bazuar.

Në fjalën përfundimtare eksperti shqyrtues deklaroj: UOPP neni 41.9 thotë kështu tenderuesi do informohet me shkrim menjëherë pas korrigjimit të këtillë, gabimet në llogaritjen do korrigjohen nga AK në këtë mënyrë: nënparagrafi A. në rast se ka mos përputhje mes çmimit për njësi dhe çmimi total që është marr duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasitë, çmimi njësi mbizotëron dhe çmimi total duhet të korrigjohet".Siç e shihni askund këtu nuk përmendet fare TVSH-ja.

Në fjalën përfundimtar eksperti shqyrtuese deklaroj; qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës, si dhe pranë konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e datës 11.05.2017

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, raportin e ekspertit shqyrtues, përgjigjet e palëve në procedurë sqaron se autoriteti kontraktues e ka eliminuar operatorin ekonomik ankues me arsyetimin se në ofertën e tij ka gabime aritmetikore mbi 2 %. Paneli shqyrtues konstaton se është e paqëndrueshme kjo arsye e eliminimit për faktin se OE ankues në ofertën e tij ka ofruar çmime për njësi ashtu siç kërkohet me LPP, mirëpo vetëm për një pozicion konkretisht pozicionin numër shtatë (oksigjen i lëngët) ka ofruar çmim për njësi prej 0.135 pa TVSH, pra ka ofruar çmim me mbi dy numra pas pikës dhjetore e që sipas nenit 18.3 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim publik nuk do të merren për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës numrat e shënuar pas numrit të dytë të pikës dhjetore, citojmë paragrafin e lartcekur "*Çmimi i ofertuar lejohet të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit te dyte (2) nuk do të merret për bazë në llogaritjen e vlerës së ofertës*". Prandaj nëse nuk merren parasysh dhe nëse nuk llogariten në vlerën e ofertës numrat pas numrit të dytë (2) pas pikës dhjetore për pozicionin e lartcekur siç parashihet me legjislacionin sekondar, atëherë rezulton se operatori ekonomik ankues ka gabime aritmetikore nën 2 % të vlerës së ofertës e jo mbi 2 % siç ka konstatuar autoriteti kontraktues.

Paneli shqyrtues duke pasur parasysh dëshmitë që u ceken më lartë dhe të gjitha faktet relevante konstaton se përmirësimi i gabimeve aritmetikore është i lejuar me ligj konkretisht me nenin 59 paragrafi 3 të LPP-së ku shkruan "*Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës*". Prandaj në këtë rast gabimet aritmetike të OE ankues nuk e kalojnë shumën dy për qind të ofertës dhe arsyeja e eliminimit të këtij operatori ekonomik është e pabazuar.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se autoriteti kontraktues me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së. Njëkohësisht nuk është respektuar edhe nenin 60 i LPP-së, respektivisht kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Qendra Klinike Universitare e Kosovës"

1x1 OE N. P. T. SH "Bubeari Komerc"-Kaçanik,

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.